



Fondi i Sigurimeve Shoqërore: **Kompenzimi i aksidenteve në vend të punës**





Autore: Antoneta Zhjeçi, Safa Xhigoli

Data: Nëntor, 2021

Publikuar nga:

Qendra për Politika dhe Avokim

www.qpa-rks.org

info@qpa-rks.org

+383 (0) 38 226 530

Të drejtat e autorit © 2021. Qendra për Politika dhe Avokim. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.

Ky publikim u realizua në kuadër të projektit “Dialogu social për drejtësi sociale” implementuar nga Koalicioni për drejtësi shoqërore dhe të drejta socio-ekonomike me financim të Olof Palme International Center dhe në mbështetje të qeverisë suedeze. Përmbajtja e këtij raporti pasqyron pikëpamjet dhe mendimet e autorëve që janë përgjegjës për faktimin dhe saktësinë e të dhënave të prezantuara këtu. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu, jo domosdoshmërisht i paraqesin ato të Olof Palme International Center apo Qeverisë Suedeze.





Tabela e përmbajtjes

Kosova	7
Gjendja aktuale	7
Korniza legjislative	12
Aksidentet në vendin e punës dhe sëmundjet profesionale	12
Korniza Institucionale	17
Analiza krahasuese	18
Kosova dhe rajoni	18
Serbia	18
Sllovenia	20
Kroacia	20
Kosova dhe Bashkimi Evropian	21
Kosova dhe ILO	34
Instrumentet kryesore mbi sigurinë dhe shëndetin në punë	35
Konventa 187 "Kudri Promovues për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, 2006"	35
Konventa 155 "Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, 1981"	36
Konventa 161 "E Shërbimeve të Shëndetit në Punë, 1985"	36
Konventa 174 "Për parandalimin e aksidenteve të rënda në industri"	36
Konventa 176 "Sigurimi dhe shëndeti në miniera"	37
Rast studimi: Letonia	38
Rekomandime	40





KOMPENSIMI I AKSIDENTEVE NË VENDIN E PUNËS

Kosova

Gjendja aktuale

Qëllimi i sigurisë dhe shëndetit në punë është të parandalojë personat nga risqet që mund të ndodhin në mjedisin e punës, sidoqoftë, arritja e këtij qëllimi është po aq kompleks sa vetë fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë. Fakti që në Kosovë nuk ka sistem për mbledhjen e të dhënave për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale ekzistuese e vështirëson përmirësimin e gjendjes së sigurisë dhe shëndetit në punë.

Të dhënat nga Raporti Vjetor i Inspektoratit të Punës shfaqin numër të lartë të aksidenteve në vendin e punës. Viti 2020 ishte viti me numrin më të lartë të aksidenteve në punë, me gjithsej 188 aksidente, që konsiderohet si numër tejet i lartë marrë parasysh faktin se veprimtaritë me rrezik më të lartë si ndërtimtaria, prodhimtaria dhe bujqësia nuk kanë operuar me muaj të tërë për shkak të pandemisë. Vetëm në sektorin e ndërtimtarisë janë regjistruar 30 aksidente gjatë vitit 2020¹, që e bën atë, ndër sektorët me rrezikshmërinë më të lartë të aksidenteve në ambientet e punës, por gjithashtu është edhe sektori më i prioritetuar për inspektime nga Inspektorati i Punës me qëllim ngritjen e vetëdijësisë dhe kushteve më të mira që garantojnë sigurinë dhe shëndetin në punë.²

Konstatimin e aksidentit në punë, varësisht nga veprimtaria e bëjnë dy institucione, Inspektorati i Punës dhe Komisioni i Pavarur për

¹ Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale: Inspektorati i Punës (2021). "Raporti i punës për vitin 2020", fq. 7. Marrë nga: <https://ip.rks-gov.net/wp-content/uploads/RAP-NARRATIV-I-IP-se-2020-002-compressed.pdf>

² Delolli, Ahmet. Inspektorati i Punës. Intervistë. 28 shtator 2021.



Miniera dhe Minerale, ku ky i fundit mbështetet në Ligjin 05/L-062 për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare, i cili përcakton parimet e përgjithshme për parandalimin e rreziqeve në punë dhe mbrojtjen e shëndetit të punonjësve në sektorin minerar, detyrimet e punëdhënësit, të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve dhe personave përgjegjës për sigurinë në punë dhe shëndetin e punonjësve, të vendosë standardet e domosdoshme për sigurinë në punë në aktivitetet minerare. Me këtë ligj synohet përmirësimi sistematik i sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve në punë, parandalimi i lëndimeve në punë, sëmundjeve profesionale dhe sëmundjeve tjera që ndërlidhen me punën e sektorit minerar.³ Ky institucion përpilon raporte në baza vjetore, ku përfshihen të dhënat mbi aksidentet dhe sëmundjet profesionale të punëmarrësve të minierave të Kosovës, statistika këto që janë të ndara nga ato të Inspektoratit të Punës.⁴

Sektorët tjerë si ndërtimtaria, prodhimaria, bujqësia, hoteleria, dhe të gjitha vendet e tjera të punës, me përjashtim të veprimtarisë minerare, bien nën përgjegjësinë e Inspektoratit të Punës në kuadër të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës.

Inspektorati i Punës si organi kompetent për konstatimin e aksidentit në vendin e punës brenda këtyre sektorëve, pranon raportim për aksident në punë nga punëdhënësi, Policia e Kosovës apo Qendrat e Mjekësisë Familjare.

Në momentin që aksidenti në ambientin e punës raportohet në Inspektoratin e Punës, koordinatori i rajonit ngarkon me rastin një inspektor i cili ka për detyrë hetimin e atij aksidenti.

³ Kuvendi i Republikës së Kosovës (2016). "Ligji nr. 05/L -062 për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare". Marrë nga: <https://gzk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=12324>

⁴ Delolli, Ahmet. Inspektorati i Punës. Intervistë. 28 shtator, 2021.



Në rastet e aksidenteve në punë, Inspektorati i Punës ka për detyrë të hetoj rastin, në bazë të provave faktike, deklaratave të stafit dhe kolegëve të punës të identifikojë shkakun e aksidentit.

Në rastet kur Inspektorati i Punës në bazë të dëshmimeve konstaton se aksidenti ka ndodhur për shkak të pakujdesisë së punëdhënësit dhe mos përmbushjes së kushteve për siguri dhe shëndet në punë shqiptohet gjobë për mos marrje të masave për siguri dhe shëndet në punë, respektivisht mos respektim të dispozitave ligjore. Për dallim nga rastet ku dëshmohet se aksidenti ka ndodhur për shkak të neglizhencës dhe pakujdesisë së vetë punëmarrësit, atëherë subjekti lirohet nga gjoba për aksident në punë, ndërsa përgjegjësia për trajtim dhe shërim mbetet tek punëmarrësi.

Nga Inspektorati i Punës, në raport me aksidentet në punë, pala që ka pësuar aksident pajiset me Raportin e Aksidentit. Hapi i radhës që mund të ndërmerret është padia civile për kompensim të dëmit të shkaktuar gjatë aksidentit në vendin e punës, të cilën e bën punëmarrësi ndaj kompanisë apo punëdhënësit të tij/saj, ku edhe procesi kalon në marrëdhënie juridike-civile.

Për ankesat e punëmarrësve të aksidentuar në punë pa kontrata të punës, ndiqet e njëjta procedurë sikurse tek punëmarrësit e aksidentuar me kontrata të punës, me të vetmin dallim që kompania në të cilën është aksidentuar i punësuar pa kontratë pune, gjobitet edhe për faktin që nuk e ka pajisur të punësuarin me kontratë të punës, për të cilën është i obliguar me ligjet në fuqi.⁵

Vlen të përmendet se Inspektorati i Punës duhet të lajmërohet për aksidentet në vendin e punës edhe kur ky i fundit ka të punësuar inspektorët e brendshëm të sigurisë.⁶

⁵ Delolli, Ahmet. Inspektorati i Punës. Intervistë. 28 shtator 2021.

⁶ Llumnica, Nexhat. Korporata Energjetike e Kosovës. Intervistë. 14 tetor 2021.



Aktualisht, mungon legjislati në fushën e shëndetit në punë në lidhje me mbikëqyrjen shëndetësore, ekzaminimet shëndetësore në punë dhe sëmundjet profesionale. Ndërsa kompensimi për sëmundjet që mund të vijnë nga ambienti dhe kushtet e punës përmenden në Ligjin nr.03/L-212 të Punës, ende nuk është i realizueshëm si pasojë e mungesës të listës së sëmundjeve profesionale, e cila do të shërbente për identifikimin e këtyre sëmundjeve, trajtimin e tyre, kompenzimin për fazën e shërimit dhe kompenzimin ndaj familjes në rastet kur punëmarrësi ndërron jetë si pasojë e sëmundjes profesionale. Në Kosovë ekzistojnë subjekte shëndetësore të cilat mirren me shëndetin në punë, por mungon rregullimi i tyre me dispozita nën-ligjore të cilat në mënyrë më precize do t'ua përcaktonin obligimet rreth mjekësisë së punës. Në praktikë, mbikëqyrja shëndetësore në vendin e punës sigurohet nga dy institucione të mjekësisë së punës, që janë Instituti i Mjekësisë së Punës i vendosur në Obiliq dhe Instituti i Mjekësisë së Punës në Gjakovë⁷, ku kjo e fundit me miratimin e Ligjit nr. 04/L-125 për Shëndetësi emërtohet si Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në nivelin terciar, si njësi organizative dhe funksionale e SHSKUK-së.⁸

Një ndër sektorët me rrezikshmërinë më të lartë dhe ekspozimit ndaj sëmundjeve profesionale në Kosovë është sektori i energjisë, ku vetëm në Korporatën Energjetike të Kosovës brenda vitit vdesin rreth 20 persona të prekur nga sëmundje të rënda si kanceri i mushkërive ose lloje të tjera të tumorëve si rezultat i ekspozimit ndaj substancave të rrezikshme për shëndetin. Identifikimi i këtyre sëmundjeve bëhet përmes vizitave mjekësore vjetore, ndërsa kompensimi për këto sëmundje nuk mund të bëhet pasi që nuk ekziston një listë zyrtare e

⁷ Curri, Minir (2018). "Siguria dhe Shëndeti në Punë: Ngritja e kapaciteteve dhe forcimin e rolit të organizatave regionale të shoqërisë civile për përmirësimin e kushteve të punës dhe dialogut me institucionet shtetërore". Marrë nga: <https://project-balkanosh.net/wp-content/uploads/2018/11/STUDIIA-KOSQVO-WFB.pdf>

⁸ Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (shikuar në 2021). "Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës Gjakovë". Marrë nga: <https://shskuk.rks.gov.net/Navbar/IndexStatic/1048>



sëmundjeve profesionale. Përsa i përket trajtimit dhe shërimit të sëmundjeve, nëse ato identifikohen në periudhën kur punonjësi mbulohet nga sigurimi shëndetësor, atëherë financiarisht mbulohet nga kompania e sigurimeve ky proces, ndërsa sëmundjet që janë identifikuar para se punonjësi të pajisej me sigurimin shëndetësor, mbulohen nga vetë punonjësi. Kur një punonjës është duke u përballur me një sëmundje dhe i njëjti shfrytëzon pushimin mjekësor, KEK-u i paguan pagën e plotë për 20 ditët e para, ndërsa për periudhën tjetër kohore deri në shërim mbulohet nga kompania e sigurimeve me 40% të pagës, por raste të tilla ku punonjësit shfrytëzojnë më shumë se 20 ditë nga pushimi mjekësor janë të rralla.⁹

Diskutime rreth përpilimit të listës së sëmundjeve profesionale ka pasur shumë, por iniciativa zyrtare ka buruar nga Këshilli Nacional për Siguri dhe Shëndet në Punë, si mekanizëm i nivelit qendror, ku përfaqësuesit e Qeverisë së bashku me partnerët social diskutojnë, dhe të gjeturat i rekomandohen qeverisë. Mungesa e një liste të tillë ndërlidhet edhe me ndërrimin e shpeshtë të Qeverive, pasi që Këshilli është kryesisht i përbërë nga përfaqësues politik, të cilët me ndërrimin e Qeverisë kanë ndaluar së punuari në Këshill, dhe rrjedhimisht në përpilimin e një liste të tillë. Sipas Divizionit të Marrëdhënieve të Punës, Dialogut Social, Shëndetit dhe Sigurisë në Punë, procesi është në fazën e rregullimit të bazës ligjore të sëmundjeve profesionale përmes projektligjit që synon ndryshim plotësimin e Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë. Me anë të këtij projektligji, përgjegjësia për hartimin e listës së sëmundjeve profesionale, menaxhimin e sistemit të Mjekësisë së Punës, mbikëqyrjen shëndetësore do të jetë mbi Ministrinë e Shëndetësisë.¹⁰

Si përfundim, çështja e shumës së kompensimit të punonjësve që pësojnë aksident në vendin e punës mbetet kompetencë e vlerësimit

⁹ Llumnica, Nexhat. Korporata Energjetike e Kosovës. Intervistë. 14 tetor 2021.

¹⁰ Ahmeti, Leunora. Ministria e Financave Punës dhe Transfereve. Intervistë. 3 gusht 2021

të gjykatës përkatëse, ndërsa çështja e kompensimit ndaj punonjësve që ballafaqohen me sëmundjet profesionale mbetet ende e pazgjidhur si mungesë e listës zyrtare për sëmundjet profesionale. Vlerësimi i gjykatës merr parasysh shkallën e lëndimit, invaliditetin e përkohshëm ose të përhershëm, me anë të së cilës përcakton edhe shkallën e kompensimit. Në qoftë se ka lëndime të rënda, duhet të merret parasysh që ai punonjës nuk arrinë më të sigurojë bukën e gojës së tij, dhe përcaktohet renta me aktgjykim ndaj punëdhënësit, kur ky i fundit është shkaktues ose kontribues i atij aksidenti.¹¹ Edhe pse rastet e tilla si aksidentet në punë apo situatat kontestimore në marrëdhënie pune duhet të merren me prioritet nga gjykata, një gjë e tillë nuk ndodh, me arsyetimin se numri i madh i lëndëve nëpër gjykata bën që lëndët prioritare të mos marrin vëmendjen e duhur, dhe lëndët të zvarriten me vite të tëra.

Korniza legjislative

Aksidentet në vendin e punës dhe sëmundjet profesionale

Sipas Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë, aksidenti në punë ose për shkak të punës cilësohet si çdo ngjarje e papritur gjatë procesit të punës, ngjarje të cilat shkaktojnë dëmtimin e menjëhershëm trupor të të punësuarit/es, dëmtim që shkakton paaftësi të përkohshme, paaftësi të përheshme, dëmtime që lidhen drejtpërdrejt me ushtrimin e veprimtarisë së punës dhe dëmtime që shkaktojnë vdekjen.¹²

Organizata Ndërkombëtare e Punës, aksidentin në punë e përkufizon si një dukuri e papritur dhe e paplanifikuar që vjen nga, ose në lidhje me punën dhe afekton një ose më shumë punonjës/e, të cilët si rrjedhojë pësojnë dëmtime fizike, sëmundje ose vdekje. Aksidentet dhe lëndimet profesionale dallojnë nga sëmundjet profesionale, të

¹¹ Hasani, Nasuf. Kryetar i Degës Regjionale të Odës së Avokatëve të Kosovës në Prishtinë. Intervistë. 20 tetor 2021.

¹² Ligji Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (2013), Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, faqe.2. Marrë nga: <https://gzk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8689>

cilat vijnë si rezultat i ekspozimit për një periudhë kohore në faktorët e rrezikut që vijnë nga aktiviteti i punës.

Pamundësia për të kryer detyrat normale të punës për shkak të lëndimeve të marra në vendin e punës përkufizohet si paaftësia e punëtorit/es për punë. Paaftësia mund të jetë e përhershme ose e përkohshme, ku ajo e përhershme përfshin rastet e lëndimit në punë kur punëtorët/et nuk kanë qenë asnjëherë në gjendje të kryejnë përsëri detyrat normale në vendin e punës, ndërsa ajo e përkohshme përfshin rastet kur punëtorët/et nuk kanë qenë në gjendje të punojnë të nesërmen nga dita e aksidentit ose edhe më gjatë, ndërsa me kalimin e kohës gjendja e tyre është përmirësuar dhe të njejtët janë kthyer në ushtrimin e detyrave normale në vendin e tyre të punës.¹³

Ndryshimet legjislative për fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë (referuar si SSHP në vazhdim) në Kosovë filluan në vitin 2008, ku ligji nr.2003/19 për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës i miratuar në vitin 2007, siguroi kornizën themelore për organizimin e sistemit të SSHP-së, por i njëjti nuk ishte harmonizuar me kërkesat dhe parimet e BE-së për mbrojtjen e punëtorëve. Përparim i madh në fushën e SSHP-së u bë në vitin 2013 kur Kosova miratoi Ligjin nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, ligj i cili përfshinte parimet kryesore të Direktivës Kornizë të BE-së 89/391/EEC për njoftimin me masat për të inkurajuar përmirësim në sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve në punë.¹⁴

Për të siguruar pajtueshmëri të plotë me Direktivën Kornizë të BE-së 89/391/EEC, Ministria e Punës dhe Mirëqenies në vitin 2019 kishte filluar procedurat për plotësim/ndryshim të ligjit për SSHP dhe

¹³ Occupational injuries (shikuar në 2021), International Labor Organization, faqe.1. Marrë nga: https://www.ilo.org/ilostat-files/Documents/description_INI_EN.pdf

¹⁴ Organizata Ndërkombëtare e Punës (2021). "Profili i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë: Promovimi i punës së denjë përmes forcimit të menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe dialogut social në Kosovë", fq.8. Marrë nga: http://wcmisq3.ilo.org/wcmisq5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/publication/wcms_797502.pdf



përgatiti një koncept dokument që identifikon ndryshimet e nevojshme legjislative. Fushat e identifikuar për përmirësim nga koncept dokumenti përfshijnë rritjen e përgjegjësisë së punëdhënësve, harmonizimin e terminologjisë së vlerësimit të rrezikut për të siguruar një kuptim më të mirë të konceptit, krijimin e një sistemi të regjistrimit, raportimit, hetimit dhe të dhënave statistikore mbi aksidentet në punë (në përputhje me Statistikat Evropiane të Aksidenteve në Punë), dhe zgjerimin e listës së incidenteve në punë që duhet të hetohen nga një punëdhënës, rritjen e rolit të përfaqësuesve të punonjësve për të siguruar komunikimin dhe pjesëmarrjen e tyre aktive, ripërcaktimin e rolit dhe kompetencave të ekspertëve të SSHP-së dhe shërbimeve të SSHP-së, si dhe përmirësimin e mbrojtjes së grupeve të ndjeshme dhe të cënueshme të punëtorëve, siç janë punëtorët e rinj, gratë, nënat gjidhënëse, personat me aftësi të kufizuara dhe personat e moshuar. Procesi i ndryshimit të Ligjit për SSHP-në filloi në vitin 2020 me miratimin e ndryshimeve, dhe i gjithë procesi pritet të finalizohet deri në dhjetor të vitit 2021.¹⁵

Ligji për Siguri dhe Shëndet në Punë përmes nenit 6 obligon punëdhënësin t'i përgjigjet të punësuarit për dëmet e shkaktuara nga lëndimi në punë, sëmundjet profesionale ose sëmundjet e lidhura me punën, sipas parimit të përgjegjësisë objektive të së drejtës së detyrimeve.¹⁶

Neni 59 i Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, thotë se, i punësuarit ka të drejtë në kompensim të pushimit mjekësor që është si pasojë e lëndimit ose sëmundjes profesionale në punë e cila ndërlikohet me kryerjen e

¹⁵ Organizata Ndërkombëtare e Punës (2021). "Profili i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë: Promovimi i punës së denjë përmes forcimit të menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe dialogut social në Kosovë", fq.13-14. Marrë nga: http://wcm3q3.ilo.org/wcm3q3/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/publication/wcms_797502.pdf

¹⁶ Kuvendi i Republikës së Kosovës (2013). "Ligji nr.04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në punë", Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, fq.3. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8689>



punëve dhe të shërbimeve për punëdhënësin me kompensim prej 70 % të pagës së tij. Me nenin 60 të po këtij ligji, rregullohet kompensimi i lëndimeve në punë, sipas së cilit punëdhënësi është i obliguar që në rast të lëndimeve dhe sëmundjeve profesionale të të punësuarit, të marra gjatë kryerjes së punës, t'ju ofrojë sigurimin për kompensimin e shpenzimeve sipas këtij ligji dhe ligjeve tjera të aplikueshme, si dhe përcakton Ministrinë, si organi kompetent për nxjerrjen e një akti nënligjor për të përcaktuar shtrirjen e sigurimit dhe për të klasifikuar lëndimet dhe shkallën e kompensimit për lëndimet e shkaktuara në punë.¹⁷

Ligji për Siguri dhe Shëndet në punë, sëmundje profesionale e konsideron çdo sëmundje të shkaktuar nga ekspozimi në elementet e dëmshme dhe të rrezikshme kimike, fizike dhe biologjike në ambientin e punës gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës.¹⁸

Protokolli i vitit 2002 i Konventës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, i vitit 1981 konsideron se termi "sëmundje profesionale" mbulon çdo sëmundje të kontraktuar si rezultat i një ekspozimi ndaj faktorëve të rrezikut që rrjedhin nga aktiviteti i punës¹⁹, ndërsa rekomandimi i Organizatës Ndërkombëtare të Punës mbi Përfitimet nga Dëmtimi në Punë i vitit 1964, përcakton sëmundjet profesionale si sëmundjet që lindin nga ekspozimi ndaj substancave dhe kushtet e rrezikshme në profesione ose në vendin e punës²⁰. Mbledhja e të dhënave në

¹⁷ Kuvendi i Republikës së Kosovës (2010). "Ligji nr.03/L-212 i Punës", fq. 18-20. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2735>

¹⁸ Ligji Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (2013), Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, faqe.2. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8689>

¹⁹ International Labour Organization (2009). "Identification and recognition of occupational diseases: Criteria for incorporating diseases in the ILO list of occupational diseases", fq. 1. Marrë nga: https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_protect/---protrav/---safework/documents/meetingdocument/wcms_116820.pdf

²⁰ International Labour Organization (2009). "Identification and recognition of occupational diseases: Criteria for incorporating diseases in the ILO list of occupational diseases", fq. 1. Marrë nga: https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_protect/---protrav/---safework/documents/meetingdocument/wcms_116820.pdf



Kosovë, në lidhje me sëmundjet profesionale është në nivel shumë të ulët, pothuajse joekzistues duke marrë për bazë faktin se nuk ka sistem të njoftimit, hetimit, diagnostikimit dhe raportimit për sëmundjet profesionale. Nuk ka asnjë listë të sëmundjeve që përbëjnë sëmundjet profesionale, dhe nuk ka rregulla të qarta se si duhen raportuar pacientët e tillë dhe si duhen mbajtur raportet mjekësore.²¹

Pjesë e legjislacionit rregullues për fushën e Sigurisë dhe Shëndetit në punë bën edhe Udhëzimi Administrativ Nr.05/2012 për kompensimin e shpenzimeve për lëndimet dhe sëmundjet profesionale të shkaktuara në punë i cili definon përgjegjësitë e punëdhënësit dhe të të punësuarit, procedurën për vërtetimin e lëndimeve në punë (përkatësisht sëmundjeve profesionale), përcakton diagnozën për lëndimet dhe sëmundjet profesionale, si dhe të drejtat e të punësuarit për mbulesat e pushimeve mjekësore.²²

Gjatë vitit 2021 janë miratuar edhe dy rregullore në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, Rregullorja (MPMS) Nr. 02/2021 për Vlerësimin e Riskut në Vendin e Punës dhe Rregullorja (MPMS) Nr. 01/2021 Për Kualifikimin e Personave Përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Licencimin e Kompanive të Shërbimeve dhe Trajtimeve për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

²¹ Organizata Ndërkombëtare e Punës (2021). "Profili i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë: Promovimi i punës së denjë përmes forcimit të menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe dialogut social në Kosovë", fq.40. Marrë nga: http://wcmsq3 ilo.org/wcmssp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/publication/wcms_797502.pdf

²² Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (2012). "Udhëzim Administrativ Nr.05/2012 për kompensimin e shpenzimeve për lëndimet dhe sëmundjet profesionale të shkaktuara në punë", Qeveria e Kosovës, fq.3-18. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8144>



Korniza Institucionale

Institucioni	Baza ligjore	Roli i institucionit
Kuvendi i Republikës së Kosovës	Kushtetuta e Republikës së Kosovës	Miratimi i legjislationit
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (Ministria e Financave Punës dhe Transfereve)	Rregullorja nr. 02/2021 për fushat e Përgjegjësisë Administrative të zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (Rregullore nr. 04/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores); Neni 11 - Ligji nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të financuara nga Shteti; Neni 60 - Ligji nr. 03/L-212 i Punës	Hartimi i legjislationit; Pensioni invalidor i punës; Organi kompetent për nxjerrjen e një akti nënligjor për të përcaktuar shtrirjen e sigurimit, për të klasifikuar lëndimet dhe për të përcaktuar shkallën e kompensimit për lëndimet e shkaktuara në punë
Këshilli Nacional për Siguri dhe Shëndet në Punë	Neni 4 - Ligji nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë	Propozimi, rekomandimi dhe përpilimi i politikave për ngritjen e nivelit të sigurisë dhe shëndetit në punë
Inspektorati i punës	Neni 24 - Ligji nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë	Mbikëqyrja e zbatimit të dispozitave të Ligjit nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë
Inspektorati i Minerave	Neni 13 - Ligji nr. 05/L-062 për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare	Mbikëqyrja e zbatimit të dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-062 për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare
Punëdhënësi	Neni 7,12 - Ligji nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë; Neni 60 - Ligji nr. 03/L-212 i Punës.	Preventimi i aksidenteve; Kompenzimi për rikuperim



Analiza krahasuese

Kosova dhe rajoni

Më poshtë jepet një përmbledhje e legjislacionit që rregullon kompenzimin e aksidenteve në punë dhe sëmundjet profesionale, në tri vende të rajonit, të cilat kanë qenë pjesë e të njejtës strukturë politike e sociale të Jugosllavisë, si Kosova. Analiza krahasuese ofrohet si shqyrtim i praktikave të vendeve të rajonit në këtë fushë dhe mënyrës se si këto vende kanë evoluar strategjinë e tyre pas shkatërrimit të Jugosllavisë.

Serbia

Tre institucione kryesore administrojnë përfitimet e sigurimeve: Fondi i Republikës për Sigurime Shëndetësore, Fondi i Republikës për Sigurim të Pensioneve dhe Aftësive të Kufizuara dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Zhvillimit Rajonal.

Në Serbi, dispozitat në lidhje me mbrojtjen nga lëndimet në punë nuk janë nën administrimin e një institucioni të vetëm. Zbatohen një sërë ligjesh dhe kujdesi mjekësor dhe përfitimet në para janë integruar brenda skemave përkatëse të sigurimit shëndetësor dhe pensioneve.

Sigurimi shëndetësor mbulon 100% të kostos së ekzaminimit, trajtimit dhe rehabilitimit pas dëmtimeve dhe sëmundjeve të lidhura me punën.²³

²³ Employment Injury Protection in Serbia, Issues and Options, 2021. Marrë nga: https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_protect/---soc_sec/documents/publication/wcms_secSOC_29968.pdf



Sa i përket përfitimeve në para për paaftësinë e përkoshme për të punuar si rezultat i dëmtimit në punë, punëdhënësi është drejtpërdrejt përgjegjës për pagesën e përfitimit nga fondet e veta gjatë tërë kohëzgjatjes së paaftësisë.²⁴

Në rast të lëndimit në punë, ligji parashikon një pension për "dëmtim trupor", domethënë një humbje, dëmtim të rëndë ose paaftësi të organeve ose pjesëve të veçanta të trupit, pavarësisht nëse kjo rezulton me paaftësi. Ekzistojnë tetë kategori të dëmtimeve trupore që variojnë nga 100% për Kategorinë 1, deri në 30% për Kategorinë 8, me një rënie prej 10% për secilën kategori. Nëse dëmi i vlerësuar është nën 30%, asnjë përfitim nuk paguhet.

Pensioni i paaftësisë së përhershme për punë, për lëndimet në punë llogaritet në të njëjtën mënyrë si pensioni i pleqërisë dhe pensioni i përgjithshëm i aftësisë së kufizuar, me ndryshim në periudhën e sigurimit ku formula është 40 vjet.²⁵

Serbia ka edhe listë zyrtare të sëmundjeve profesionale, e cila është përditësuar së fundmi, më 2019, ku në vend 56 sëmundjeve të listuara, lista e re përmban 64 sëmundje profesionale. Ajo hartohet dhe shqyrtohet nga Ministria e Punës, Punësimi, Çështjeve të Veteranëve dhe Çështjeve Sociale të Qeverisë së Serbisë. Instituti i Mjekësisë së Punës po ashtu shqyrton dhe mbikëqyr këtë listë.²⁶

²⁴ Employment Injury Protection in Serbia, Issues and Options, 2021. Marrë nga: https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_protect/---soc_sec/documents/publication/wcms_secSOC_29968.pdf

²⁵ Employment Injury Protection in Serbia, Issues and Options, 2021. Marrë nga: https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_protect/---soc_sec/documents/publication/wcms_secSOC_29968.pdf

²⁶ Revised list of occupational diseases in Serbia, 2019. Marrë nga: <https://www.srbija.gov.rs/vest/368660/revidirana-lista-profesionalnih-bolesti-u-srbiji.php>



Sllovenia

Lëndimet në punë definoohen të gjitha lëndimet që ndodhin si rezultat i kryerjes së punës apo në proces të punës. Sëmundjet profesionale definoohen në listën zyrtare të sëmundjeve profesionale.²⁷ Personat e siguruar detyrimisht dhe ata vullnetarisht përfshihen në dy sisteme të sigurimit në rast lëndimi në punë. Sistemi për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor mbulon rreziqet në lidhje me paaftësinë për të punuar.

Në rast të lëndimit në punë apo të sëmundjes profesionale personit të siguruar i mbulohehet e gjithë kostoja e trajtimit mjekësor esencial si dhe rehabilitimit nga sistemi e detyrueshëm i sigurimit. Në rast të sëmundjes, punëdhënësi paguan për 30 ditët e para të sëmundjes së punëtorit, ndërsa më pas me kompensimin e punëtorit merret plotësisht Instituti i Sigurimeve Shëndetësore të Sllovenisë, deri sa personit të lënduar apo sëmurë ti rikthehet aftësia për punë. Në rast të paaftësisë për punë të rezultuar nga aksidenti në punë, personi i siguruar ka të drejtë për pension invaliditeti. Nëse paaftësia për punë është rezultat i dëmtimit profesional apo ndonjë sëmundjeje profesionale, pensioni i paaftësisë për punë llogaritet në 63.50% të bazës së pensionit.²⁸

Kroacia

Aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale në Kroaci mbuloohen nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor dhe pensioni i detyrueshëm. Në rast të paaftësisë së përkoshme për punë shpenzimet mbuloohen nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor, kurse në rast të paaftësisë së përhershme, shpenzimet mbuloohen nga pensioni i detyrueshëm.

²⁷ Rules on the list of occupational diseases. Marrë nga: <http://www.pisrs.si/Pis.web/pregledPredpisa?id=PRAV5202>

²⁸ Slovenia-Occupational Injury and occupational diseases. Marrë nga: <https://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=1128&langId=en&intPagelD=4779>



“Aksident në punë” përkufizohet si aksidenti gjatë punës si dhe gjatë shkuarjes në punë. “Sëmundje profesionale” përkufizohet si sëmundje që rezulton nga ekzpozimi direkt afatgjatë ndaj një pune të caktuar dhe vetëm sëmundjet nga lista zyrtare e sëmundjeve profesionale konsiderohen si të tilla.

Të gjithë punëtorët përfshihen në skemë, përfshirë të vetë punësuarit, fermerët, si dhe grupet speciale për të cilët ofrohet sigurim p.sh: studentët gjatë praktikës dhe trajnimit apo edhe anëtarët vullnetarë të zjarrfikësve. Brenda sistemit të sigurimit të pensionit, janë tre lloje pensionesh sa i përket aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale: pension invaliditeti, rehabilitim profesional dhe benefitet nga dëmtimi.

Sëmundjet profesionale rregullohen me ligj të veçantë dhe dëmtimet trupore me ligj tjetër. Një person ka të drejtën e benefiteve nga dëmtimet trupore nëse ka pësuar aksident në punë apo është sëmurë nga ndonjë sëmundje profesionale. Dëmtimet trupore dhe nivelet e tyre shprehen në përqindje nga 30% në 100% dhe përcaktohen me ligj. Norma e pagesës varet nga niveli i dëmtimit trupor dhe shkon nga 12% në 40% të bazës përkatëse të llogaritjes.²⁹

Kosova dhe Bashkimi Evropian

Direktivat e para për sigurinë dhe shëndetin në punë, në nivelin evropian, u miratuan në bazë të dispozitave të përgjithshme të harmonizimit të tregut, kjo për shkak të mungesës së kompetencave të qarta legjislative brenda traktateve të deri atëherëshme për fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Akti Unik Evropian i vitit 1987 ishte një hap i madh përpara në atë që prezantoi një dispozitë të re ligjore mbi politikën sociale në traktat duke synuar përmirësimin e mjedisit të punës, veçanërisht shëndetin

²⁹ Croatia - Accidents at work and occupational diseases. Marrë nga: <https://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=1104&langId=en&intPagelId=4461>



dhe sigurinë e punëtorëve. Me futjen e kësaj dispozite në traktat, u kuptua rëndësia e kushteve të sigurta të punës. Me Traktatin e Mاستrihitit në 1993, për t'i dhënë ende shtysë kësaj fushe, Kapitulli i ri Social autorizoi Komisionin Evropian për të promovuar dialogun social midis punëdhënësve dhe përfaqësuesve të punës në nivelin Evropian.

Me Traktatin e Amsterdimit të vitit 1997, kompetenca legjislativë në fushën e politikave sociale evropiane u forcua edhe më tej nga përfshirja e marrëveshjes sociale në këtë traktat³⁰.

Neni 153 i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian i jep BE - së autoritetin për të miratuar legjislacion (direktiva) në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, në mënyrë që të mbështesë dhe plotësojë aktivitetet e Shteteve Anëtare.³¹

- Direktiva Kornizë Evropiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (Direktiva 89/391 KEE) përcakton parimet kryesore për të inkurajuar përmirësimet në fushën e sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve në punë. Kjo direktivë garanton kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në të gjithë Evropën, ndërsa shtetet anëtare lejohen të mbajnë ose vendosin masa më të rrepta. Direktiva Kornizë shoqërohet me direktiva të tjera që fokusohen në aspekte të veçanta të sigurisë dhe shëndetit në punë, ku së bashku formojnë bazat e legjislacionit evropian të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Legjislacioni kryesor i SSHP-së në Kosovë bazohet në Direktivën Kornizë të BE-së dhe legjislacioni sekondar bazohet në direktivat

³⁰ European Agency for Safety and Health at work (shikuar në 2021). "European directives on safety and health at work: Historical background on safety and health legislation". Marrë nga: <https://osha.europa.eu/en/safety-and-health-legislation/european-directives>

³¹ European Commission (shikuar në 2021). "Health and safety at work: Legal Basis". Marrë nga: <https://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=148>

individuale, të cilat parashohin kërkesa plotësuese të hollësishme për secilin aspekt të veçantë të SSHP-së. Në periudhën kohore 2016-2017 janë transpozuar 15 direktiva të BE-së, ndërsa në vitin u miratuan dy rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e rregulloreve ekzistuese, asaj 04/2014 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës dhe asaj 05/2014 për Kërkesat Minimale të Sigurisë dhe Shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës.



Direktiva e transpozuar e BE-së	Akti ligjor në Kosovë
Direktiva 89/654/EEC e 30 nëntorit 1989 në lidhje me kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës;	Rregullorja (MPMS) nr. 01/2020 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (MPMS) nr. 04/2014 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës;
Direktiva 2009/104/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 16 shtatorit 2009 në lidhje me kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve të punës nga punëtorët në vendin e punës;	Rregullore (MPMS) nr. 02/2020 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 05/2014 për Kërkesat Minimale të Sigurisë dhe Shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendin e punës;
Direktiva 89/656/EEC e 30 nëntorit 1989 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve personale mbrojtëse në vendin e punës;	Rregullorja (MPMS) nr. 02/2016 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve personale mbrojtëse në vendin e punës;
Direktiva e Këshillit 90/269/EEC e 29 majit 1990 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për punën e krahut me ngarkesa kur ekziston rrezik sidomos i dëmtimit të shpinës për punëtorët;	Rregullorja (MPMS) nr. 03/2016 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për mbrojtjen e të punësuarve lidhur me punën e krahut me ngarkesa;



<p>Direktiva 92/58/EEC e 24 qershorit 1992 për kërkesat minimale për sigurimin e shenjave të sigurisë dhe/ose shëndetit në punë;</p>	<p>Rregullorja (MPMS) nr. 04/2016 për kërkesat minimale për sigurimin e shenjave të sigurisë dhe shëndetit në punë;</p>
<p>Direktiva 90/270/EEC e 29 majit 1990 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për punën me pajisje me ekran shfaqës;</p>	<p>Rregullorja (MPMS) nr. 06/2016 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për punën me pajisje me ekran shfaqës;</p>
<p>Direktiva 1999/92/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 16 dhjetorit 1999 për kërkesat minimale për përmirësimin e sigurisë dhe mbrojtjes shëndetësore të punëtorëve potencialisht në rrezik nga ambientet shpërthyes;</p>	<p>Rregullorja (MPMS) nr. 05/2016 për kërkesat minimale për sigurinë dhe shëndetin në punë të të punësuarve në risk nga ambientet shpërthyes;</p>
<p>Direktiva 2002/44/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 25 qershorit 2002 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në lidhje me ekspozimin e punëtorëve ndaj rreziqeve që vijnë nga agjentët fizikë (dridhja);</p>	<p>Rregullorja (MPMS) nr. 01/2017 për mbrojtjen e të punësuarve nga rreziqet lidhur me dridhjen në vendin e punës;</p>
<p>Direktiva 2003/10/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 6 shkurtit 2003 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në lidhje me ekspozimin e punëtorëve ndaj rreziqeve që vijnë nga agjentët fizikë (zhurma);</p>	<p>Rregullorja (MPMS) nr. 02/2017 për mbrojtjen e të punësuarve nga risqet lidhur me zhurmën në vendin e punës</p>

<p>Direktiva e Këshillit 92/57/EEC e 24 qershorit 1992 për zbatimin e kërkesave minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendndërtimet e përkohshme apo mobile;</p>	<p>Rregullorja (MPMS) nr. 06/2017 për kriteret minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendndërtimet e përkohshme apo mobile;</p>
<p>Direktiva 2009/148/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 30 nëntorit 2009 për mbrojtjen e punëtorëve nga rreziqet e lidhura me ekspozimin ndaj azbestit në punë;</p>	<p>Rregullorja (MPMS) nr. 07/2017 për mbrojtjen e të punësuarve nga rreziqet e lidhura me ekspozimin ndaj azbestit në punë;</p>
<p>Direktiva e Këshillit 98/24/EC e 7 prillit 1998 për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit së punëtorëve nga rreziqet e lidhura me agjentët kimikë në punë (direktiva e katërmbëdhjetë individuale), Direktivat 91/322/EEC, 2000/39/EC, 2006/15/EC, 2009/161/EU për listat e vlerave indikative të kufijve të ekspozimit;</p>	<p>Rregullorja (MPMS) nr. 10/2017 për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve nga risqet e lidhura me agjentët kimikë në punë;</p>
<p>Direktiva 2004/37/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 29 prillit 2004 për mbrojtjen e punëtorëve nga rreziqet e lidhura me ekspozimin ndaj kancerogjenëve ose mutagjenëve në punë;</p>	<p>Rregullorja (MPMS) nr. 04/2017 për mbrojtjen e të punësuarve nga risqet e lidhura me kancerogjenët dhe mutagjenët në punë;</p>
<p>Direktiva 2000/54/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 18 shtatorit 2000 për mbrojtjen e punëtorëve nga rreziqet e lidhura me ekspozimin ndaj agjentëve biologjikë në punë;</p>	<p>Rregullorja (MPMS) nr. 05/2017 për mbrojtjen e të punësuarve nga risqet e lidhura me ekspozimin ndaj agjentëve biologjikë në punë;</p>



<p>Direktiva 2010/32/EU e 10 majit 2010 për zbatimin e Marrëveshjes Kornizë për parandalimin e lëndimeve nga mjetet e mprehta në sektorin e kujdesit shëndetësor dhe spitalor;</p>	<p>Rregullorja (MPMS) nr. 03/2017 për parandalimin e lëndimeve nga mjetet e mprehta në vendet e punës pranë sektorit të kujdesit shëndetësor dhe spitalor;</p>
<p>Direktiva 2006/25/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 5 prillit 2006 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në lidhje me ekspozimin e punëtorëve ndaj rreziqeve që vijnë nga agjentët fizikë (rrezatimi optik artificial);</p>	<p>Rregullorja (MPMS) nr. 09/2017 për mbrojtjen e të punësuarve nga risqet e lidhura me rrezatimin optik në vendin e punës;</p>
<p>Direktiva 2004/40/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 29 prillit 2004 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë në lidhje me ekspozimin e punëtorëve ndaj rreziqeve që vijnë nga agjentët fizikë (fushat elektromagnetike);</p>	<p>Rregullorja (MPMS) nr. 08/2017 për mbrojtjen e të punësuarve nga risqet e lidhura me fushat elektromagnetike në vendin e punës;</p>



Pasi që legjislacioni kryesor i SSHP-së në Kosovë bazohet në Direktivën Kornizë të BE-së dhe synimi afatgjatë i Kosovës është anëtarësimi në BE, në këtë tabelë ofrohet analizë krahasuese në mes 10 shteteve evropiane rreth politikave të secilës prej tyre në fushën e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale, në mënyrë që të ofrohen praktika nga këto shtete. Në tabelë krahasohen mbulueshmëria e benefiteve në rast të aksidentit në punë apo ndonjë problemi shëndetësor si rezultat i ndonjë sëmundjeje profesionale që mund të rezultojë në paaftësi për punë të përkohshme, të përhershme apo edhe vdekje. Po ashtu, në tabelë tregohen edhe institucionet relevante që zakonisht merren me apo kontaktohen në rast të aksidenteve në punë apo sëmundjeve profesionale. Të dhënat në tabelë janë të bazuara në të dhënat e Komisionit Evropian, divizioni i Koordinimit të Sigurimeve Sociale.³²

³² Your rights country by country. Employment Social Affairs and Inclusion. European Union. Marrë nga: <https://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=858&langId=en>



Shteti	Kush mbulohet	Institucionet relevante që duhet të kontaktohen	Kush e mbulon kompensimin dhe sa?
Belgjikë	<p>Punëtorët e sektorit privat me kontrata.</p> <p>Përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • studentët në trajnim • nxënësit në rrezik ndaj ekspozimit të ndonjë sëmundje profesionale gjatë trajnimit të tyre <p>Punëtorë e sektorit publik</p>	<ul style="list-style-type: none"> ○ Agjencia Federale për Rreziqet Profesionale 	Tërësisht i mbuluar nga Agjencia Federale për Rreziqe Profesionale (FEDRIS)
Kroacia	<p>Të gjithë punëtorët përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të vetëpunësuarit • fermerët • studentët nën trajnim • vullnetarët në vende pune me rrezik 	<ul style="list-style-type: none"> ○ Fondi Kroat i Sigurimeve Shëndetësore ○ Instituti Kroat i Sigurimeve Pensionale ○ Ministria e Punës, Sistemit Pensional, Familjes dhe Politikave Sociale ○ Ministria e Shëndetësisë 	Tërësisht nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor dhe pensioni i detyrueshëm, pjesë e Fondit Kroat të Sigurimeve Shëndetësore dhe Institutit Kroat të Sigurimeve Pensionale
Danimarkë	<ul style="list-style-type: none"> • Punëtorët e rregullt • Të vetëpunësuarit • Marinarët e punësuar në anije daneze 	<ul style="list-style-type: none"> ○ Sigurimi i tregut të punës ○ Bordi Kombëtar i Ankesave Sociale 	Tërësisht nga Sigurimi i tregut të punës së Danimarkës

	<ul style="list-style-type: none"> Fëmijët që kanë marrë sëmundje para lindjes së tyre si rezultat i punës së nënës së tyre³³ 	<ul style="list-style-type: none"> Autoriteti Danez i Mjedisit të Punës Ministria e Punësimit 	
Gjermania	<p>Të gjithë punëtorët me kontrata Veçanërisht, këta persona kanë mbulim të detyrueshëm nga skema shtetërore e sigurimit të aksidenteve:</p> <ul style="list-style-type: none"> Punonjësit manual dhe të zyrës <ul style="list-style-type: none"> Nxënësit Disa persona të vetëpunësuar Fëmijët në qendrat e kujdesit ditor Nxënësit që ndjekin shkollat jo-profesionale ose profesionale Studentët që i nënshtrohen arsimit në nivelin terciar, Përfituesit e pagesave të rehabilitimit Vullnetarë të caktuar Personeli i kujdesit shtëpiak 	<ul style="list-style-type: none"> Sigurimi ligjor gjerman i aksidenteve Ministria Federale e Punës dhe Çështjeve Sociale 	<p>Sigurimi shtetëror i aksidenteve paguan për sëmundjet profesionale dhe aksidentet në punë</p> <p>Punëdhënësi paguan kontributet e sigurimit të aksidentit për punonjësit manualë dhe ata në zyra si dhe praktikantët</p> <p>Të vetëpunësuarit duhet të paguajnë vetë kontributet duke u regjistruar në mënyrë vullnetare për sigurime kundrejt aksidenteve në punë përmes shoqatave profesionale</p>

³³ WORKERS' COMPENSATION ACT Denmark. Marrë nga:
<https://www.legislationline.org/download/id/1287/file/82daad22d0da7733049a53cbce86.pdf>



Polonia	<ul style="list-style-type: none"> • Punëtorët e siguruar me sigurimin e detyrueshëm të aksidenteve në punë 	<ul style="list-style-type: none"> ○ Ministria e Familjes, Punës dhe Politikës Sociale - Departamenti i Sigurimeve Sociale ○ Instituti i Sigurimeve Sociale (ZUS) 	Benefitet paguhen tërësisht nga sigurimi i detyrueshëm i aksidenteve në punë, i cili mbulon shumicën e punëtorëve.
Letonia	<ul style="list-style-type: none"> • Punëtorët e sektorit publik dhe privat të siguruar me sigurim social³⁴ 	<ul style="list-style-type: none"> ○ Agjencia Shtetërore e Sigurimeve Sociale ○ Komisioni Mjekësor Shtetëror për Vlerësimin e Gjendjes Shëndetësore dhe Aftësisë për Punë ○ Inspektorati Shtetëror i Punës ○ Ministria e Mirëqenies 	Tërësisht nga Agjencia Shtetërore e Sigurimeve Sociale
Zvicra	<p>Çdokush që jeton ose angazhohet në një punë me pagesë në Zvicër përfshirë: -punonjësit</p> <ul style="list-style-type: none"> • të vetëpunësuar • ata që nuk punojnë • është i siguruar sipas shtyllës së parë së sigurimeve, pension invaliditeti i sigurimit të invaliditetit 	<ul style="list-style-type: none"> ○ Zyra Federale e Sigurimeve Sociale (FSIO) 	Tërësisht nga Fondi Kombëtar Zviceran për Sigurimin e Aksidenteve dhe sigures të tjerë

³⁴Të vetëpunësuarit, përfshirë edhe fermerët të cilët punojnë për përfitimin e tyre dhe nuk punësojnë punëtorë nuk mbulohen.



Norvegjia	<ul style="list-style-type: none"> • Çdo punëtor anëtar i Skemës Kombëtare të Sigurimeve (p.sh.duhet të jetë rezident në Norvegji, me një punëdhënës në Norvegji ose në zonën norvegjeze të "shelf"-it kontinental)³⁵ 	<ul style="list-style-type: none"> ○ Administrata Norvegjeze e Punës dhe Mirëqenies (NAV) 	Tërësisht nga Kompania e sigurimit të punëdhënësit përkatës, pjesë e Skemës Kombëtare të Sigurimeve
Rumania	<p>Për tu mbuluar me benefite një person duhet të jetojë ose të jetë rezident në Rumani dhe të jetë i siguruar nga rreziku i aksidenteve në punë ose sëmundjeve profesionale.</p> <p>Personat që kanë sigurim të detyrueshëm për këto rreziqe janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Personat që janë të punësuar sipas një kontrate pune individuale (përfshirë shtetas të huaj ose persona pa shtetësi që punojnë për punëdhënësit rumunë gjersa jetojnë ose janë rezidentë në Rumani) • Personat që janë zgjedhur në pozicionet që ata mbajnë dhe që punojnë për një institucion ekzekutiv, legjislativ ose gjyqësor • Nëpunësit civilë • Të papunë gjatë trajnimit profesional 	<ul style="list-style-type: none"> ○ Autoritetet e Pensionit Shtetëror të Konteve përkatëse 	Nga agjensionet e sigurimit përkatëse dhe autoritetet e pensioneve territoriale

³⁵ Të vetëpunësuarit ose profesionistët e pavarur, duhet të marrin vetë sigurimin vullnetar të lëndimeve profesionale.



	<ul style="list-style-type: none"> • Studentët gjatë formimit profesional; • Vullnetarë që punojnë në shërbimet e urgjencës • Shtetasit rumunë që punojnë jashtë vendit për punëdhënësit rumunë. 		
Portugalia	<ul style="list-style-type: none"> • Punonjësit me rrogë, me përjashtim të punonjësve të administratës publike • Punëtorët shëtpiakë me kusht që ata të jenë të regjistruar si punonjës me rrogë • Punonjësit e vetëpunësuar (të vetëpunësuarit që përdorin skemën «recibos verdes» ose sipërmarrës që veprojnë në emër të tyre) të cilët kontribuojnë në sigurimet sociale • Personat e regjistruar për sigurime shoqërore vullnetare, nëse kanë kontribuar 0.5% për shëndetin në punë 	<ul style="list-style-type: none"> ○ Segurança Social (Sigurimi Social i Portugalisë) 	Tërësisht nga benefitet e Përfshirjes Sociale (Prestação social para a inclusão)



Kosova dhe ILO

Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO- International Labour Organization), krijuar në vitin 1919, është e përkushtuar në promovimin e drejtësisë sociale, të drejtave të njeriut dhe të punës të njohura ndërkombëtarisht. Kushtetuta e ILO -s përcakton që punëtorët duhet të mbrohen nga sëmundjet dhe lëndimet që vijnë nga punësimi i tyre. Standardet e ILO-s rreth sigurisë dhe shëndetit në punë ofrojnë mjete thelbësore për qeveritë, punëdhënësit dhe punëtorët për të krijuar praktika të tilla dhe për të garantuar sigurinë maksimale në punë.

ILO ka miratuar më shumë se 40 standarde që kanë të bëjnë veçanërisht me sigurinë dhe shëndetin në punë, si dhe mbi 40 Kode të Praktikës. Pothuajse gjysma e instrumenteve të ILO-s merren drejtpërdrejt ose tërthorazi me çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Legjislacioni i Kosovës reflekton parime kryesore nga disa konventa të ILO-së. Si p.sh: Konventa për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, 1981 (Nr.155); Konventa e Javës Dyzetorëshe, 1935 (Nr. 47); dhe Korniza Promovuese për Sigurinë në Punë dhe Konventa për Shëndetin, 2006 (Nr. 187).

Disa nga kodet e praktikës së ILO-së mbi Sigurinë dhe Shëndetin në Punë të cilat ofrojnë udhëzime për një sërë temash, përfshirë minierat, përdorimin e kimikateve, njoftimet rreth aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale, janë përfshirë në udhëzuesin për Inspektoratin e Punës në kuadër të projektit EuropeAid "Mbështetje për punën e Inspektoratit në luftimin e punës së padeklaruar. Ky udhëzues pritet të përdoret nga Inspektorati i Punës gjatë hetimeve të aksidenteve në



punë dhe hetimeve të zonave të ndërtimit gjatë vitit 2021, sipas raportit më të fundit të ILO-së.³⁶

Edhe listat e përdorura nga Inspektorët e Punës rreth faktorëve të rrezikshëm në punë, si kimikatet, i referohen Kodeve të Praktikës së ILO-së.

Për më tepër nuk ka të dhëna zyrtare për ndonjë kompani kosovare, që është certifikuar me ndonjë prej standardeve të njohura për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, të tilla si OHSAS 18001 (Seritë e Vlerësimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë) apo ISO 45001: 2018 ("Sistemet e menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë- Kërkesat me udhëzime për përdorim").³⁷

Instrumentet kryesore mbi sigurinë dhe shëndetin në punë

Konventa 187 "Kudri Promovues për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, 2006"

Si një instrument që përcakton një kuadër promovues, kjo Konventë është krijuar për të siguruar trajtim koherent dhe sistematik të çështjeve të sigurisë dhe shëndetit në punë dhe për të promovuar njohjen e Konventave ekzistuese mbi sigurinë dhe shëndetin në punë. Konventa ka për qëllim krijimin dhe zbatimin e politikave koherente kombëtare për sigurinë dhe shëndetin në punë përmes dialogut midis qeverisë, organizatave të punëtorëve dhe punëdhënësve dhe për të

³⁶ Occupational Safety and Health Profile, Promoting decent work through strengthening occupational safety and health management and social dialogue in Kosovo, 2021. Marrë nga: https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/publication/wcms_797477.pdf

³⁷ Occupational Safety and Health Profile, Promoting decent work through strengthening occupational safety and health management and social dialogue in Kosovo, 2021. Marrë nga: https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/publication/wcms_797477.pdf



promovuar një kulturë parandaluese kombëtare të sigurisë dhe shëndetit.

Konventa 155 "Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, 1981"

Konventa parashikon miratimin e një politike kombëtare koherente të sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe veprime që duhen ndërmarrë nga qeveritë dhe brenda ndërmarrjeve për të promovuar sigurinë dhe shëndetin në punë dhe për të përmirësuar kushtet e punës. Kjo politikë do të zhvillohet duke marrë parasysh kushtet dhe praktikat kombëtare. Protokollin bën thirrje për krijimin dhe rishikimin periodik të kërkesave dhe procedurave për regjistrimin dhe njoftimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në punë, si dhe publikimin e statistikave vjetore përkatëse.

Konventa 161 "E Shërbimeve të Shëndetit në Punë, 1985"

Kjo konventë parashikon krijimin e shërbimeve të shëndetit në punë të nivelit të ndërmarrjes, të cilave u janë besuar funksione kryesisht parandaluese dhe që janë përgjegjës për këshillimin e punëdhënësit, punëtorëve dhe përfaqësuesve të tyre në ndërmarrje për ruajtjen e një mjedisi të sigurt dhe të shëndetshëm pune.

Konventa 174 "Për parandalimin e aksidenteve të rënda në industri"

Qëllimi i kësaj Konvente është të parandalojë aksidentet e rënda nga lëndët e rrezikshme dhe të minimizojë pasojat e aksidenteve të tilla. Për këtë qëllim, secili shtet ka detyrimin për të formuluar, implementuar dhe shqyrtuar në mënyrë periodike një politikë kombëtare në lidhje me mbrojtjen e punëtorëve nga aksidentet e mëdha. Për më tepër, me bazë këtë Konventë, punëtorët kanë të drejtë jo vetëm të informohen në lidhje me rreziqet që ekzistojnë për shkak të veprimtarisë që kryejnë, apo për urdhrat dhe rekomandimet e autoriteteve kompetente, por kanë dhe detyrimin që



të marrin masa deri në ndërprerjen e aktivitetit kur kanë dyshime se ekziston një rrezik evident për një aksident të rëndë.

Konventa 176 "Sigurimi dhe shëndeti në miniera"

Kjo konventë parashikon rregullime specifike për sigurinë dhe shëndetin në punë në sektorin e minierave. Sipas Konventës, punëdhënësi duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të eliminuar ose zvogëluar në minimum rreziqet për sigurinë dhe shëndetin që paraqesin minierat nën autoritetin e tij, si dhe detyrohet të kujdeset që miniera të vihet në shërbim, të shfrytëzohet, mirëmbahet dhe të deklasohet, në mënyrë të tillë që punonjësit të mund të kryejnë detyrat e caktuara pa rrezik për sigurinë dhe shëndetin e tyre ose të personave të tjerë.



Rast studimi: Letonia

Letonia, një shtet Baltik me sipërfaqe të vogël dhe numër të ngjashëm të popullësisë me Kosovën ofron një shembull të shkëlqyer të rregullimit të kompensimit të aksidenteve në punë dhe paaftësinë si rezultat i saj, pasi që ka legjisllacion që shpjegon kompensimin e aksidenteve në punë në mënyrë numerike, dhe nga i cili legjisllacion, në fund, pasi që ka paralele shtetërore, mund të nxjerren rekomandime për Kosovën. Më poshtë jepet një përmbledhje e legjisllacionit të Letonisë sa i përket kompenzimit të aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale.

Kompenzimet dhe benefitet për aksidente në punë apo sëmundjet profesionale, në Letoni, vijnë në formë të: kompenzimi për humbjen e kapacitetit për punë, kompenzimi për humbje të kryefamiljarit (apo mbajtësit të bukës), benefitet e sëmundjes si dhe kompenzimi trajtim mjekësor.

Në rast të humbjes së përkohshme të aftësisë për punë, si rezultat i një aksidenti në punë apo sëmundjeve profesionale, punëtori ka të drejtë të përfitojë nga benefitet e sëmundjes. Në rast të humbjes afatgjatë apo të përhershme të aftësisë për punë, një punëtor ka të drejtë të përfitojë nga kompenzimi i humbjes së kapacitetit për punë. Në rast se punëtori vdes si rezultat i ndonjë aksidenti në punë dhe është kryefamiljar, familja ka të drejtë përfitimi të kompenzimit të humbjes së kryefamiljarit.³⁸

Në rast të sëmundjeve profesionale, benefitet e sëmundjes fillojnë të aplikohen që nga dita e parë e sëmundjes.

Në rast të kompensimit të humbjes së aftësisë për punë, ai mund të përfitohet nëse punëtori ka humbur të paktën 25% të aftësisë për punë. Kompenzimi llogaritet në varësi të përqindjes së vlerësuar të

³⁸ Latvia - Compensation in case of accidents at work or occupational diseases. Marrë nga: <https://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=1117&langId=en&intPagelId=4637>



humbjes së aftësisë për punë (duke filluar nga 25%) dhe pagës mesatare të kontributit të punëtorit. Në rast të humbjes së aftësisë për punë prej 100%, proporcioni i pagës mesatare të kontributit llogaritet si 80% dhe kështu vazhdon të bie deri në 35% për humbje të aftësisë për punë minimale prej 25%. Kompenzimi paguhet çdo muaj.³⁹

Kompenzimi për humbje të kryefamiljarit paguhet po ashtu çdo muaj varet nga numri i personave të varur apo fëmijët dhe paga mesatare e kontributit, ku për fëmijët që përveç se nuk e kanë pasur njërin prind para aksidentit, kompenzimi dyfishohet në secilën përllogaritje.

Sëmundjet profesionale janë të listuara në Shtojcën 1 të Rregullores së Kabinetit të Ministrave Nr.908 "Procedurat për Hetimin dhe Regjistrimin e Sëmundjeve Profesionale", dhe ndahen në 7 kategori.⁴⁰

³⁹ Latvia - Compensation in case of accidents at work or occupational diseases. Marrë nga: <https://ec.europa.eu/social/main.jsp?catId=1117&langId=en&intPagId=4637>

⁴⁰ Latvia.LEGOSH- Occupational Safety and Health (OSH). Marrë nga: https://www.ilo.org/dyn/legosh/en/f?p=LEGPOL:1100:11638820789771:::P1100_THEME_ID:10000



Rekomandime

Për të përmirësuar mënyrën e kompensimit të aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale, rekomandimet kryesore janë:

Për politikëbërësit

~ Rifunksionalizimi i Këshillit Nacional për Siguri dhe Shëndet në Punë, si mekanizëm për ngritjen e nivelit të sigurisë dhe shëndetit në punë.

~ Hartimi i Listës së Sëmundjeve Profesionale nga institucionet relevante, si dhe hartimi i vendimit/akteve nënligjore për trajtimin e tyre, kompenzimin për fazën e shërimit dhe kompenzimin ndaj familjes në rastet kur punëmarrësi ndërron jetë si pasojë e sëmundjes profesionale.

~ Përpilimi dhe detajizimi i legjislacionit ku përcaktohen në mënyrë të tërthortë kompenzimet si: kompenzimi për humbjen e kapacitetit për punë, kompenzimi për humbje të kryefamiljarit, kompenzimet e sëmundjeve profesionale si dhe kompenzimi për trajtim mjekësor.

~ Përcaktimi me numra dhe përqindje në legjislacion për kompenzimin e humbjes së kapacitetit për punë, ku kompensimi llogaritet në varësi të përqindjes së vlerësuar të humbjes së kapacitetit për punë (ku në shumicën e vendeve të BE-së fillon në 25%) dhe pagës mesatare të kontributit.

~ Përpilimi i një dokumenti ku përcaktohet detajisht shuma e kompensimit për bashkëshort/e dhe fëmijë deri në moshën 18 vjeqare në rast të humbjes së jetës së kryefamiljarit në vendin e punës.

~ Rirregullimi dhe funksionalizimi i komisioneve shtetërore mjekësore për vlerësimin e gjendjes shëndetësore dhe aftësisë për punë.



~ Kategorizimi dhe përcaktimi i lëndimeve të lehta, mesme dhe të rënda në legjislacion, si pasojë e aksidenteve në vendin e punës.

Për shoqërinë civile

~ Të drejtohen përpjeket e organizatave të shoqërisë civile për edukim të punëmarrësve/eve dhe punëdhënësëve/eve lidhur me rëndësinë e sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës, si dhe marrëdhënies në punë.

~ Të ngritet niveli i ofrimit të asistencës teknike për rastet e punëmarrësve/eve të cilët aksidentohen në vendin e punës, dhe që kompensimin e kërkojnë përmes padisë civile, në mënyrë që të gjithë të aksidentuarit në vende të punës të kompensohen për dëmin e shkaktuar.

~ Të jenë më proaktive në draftimin e politikave nacionale për kompensimin e aksidenteve/sëmundjeve profesionale në vend të punës.

